
**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NJLBITOPAFAY CONSULTING” sh.p.k.**

Sot, më datë __27__12__2022, personat e mëposhtëm:

- **Znj. ORLANDA DI SALVATORE**, shtetase Italiane, i bija e Marco, lindur me 02.11.1968 ne Ortona (Ch), Itali dhe banues ne Empoli, Itali, mbajtëse e pasaportes me nr. YA4870455, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

vendosi të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

**Neni 1
Themelimi**

- 1.1 Emri i shoqërisë është “**NJLBITOPAFAY CONSULTING**” Sh.p.k., këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

**Neni 2
Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr.Fatmir Haxhiu, Pallati 2, Hyrja 2, Ndertesa nr.5, Apartamenti 86, Kodi Postar 1001, Tirane.
- 2.2 Shoqëria mund të hap degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

**Neni 3
Objekti**

- 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:
Shoqëria mund të ushtroj shit-blerje e kuotave dhe /ose aksioneve në kompani të tjera. Pjesëmarrje direkte dhe/ose indirekte në aktivitetet tregtare. Konsulencë ligjore, financiare, tregtare, menaxhim për palë të treta dhe shoqëri të investuara, pjesëmarrëse, bashkëpunëtoresh dhe/ose të lidhur në përgjithësi. Aktivitet ndërmjetësimi biznesi, bankare dhe/ose financiare në



përgjithësi, si dhe investime në emër të palëve të treta. Regjistrim në mirëbesim të kuotave dhe/ose aksioneve si dhe menaxhimin e tyre apo edhe në emër të palëve të treta. Import-Eksport të mallrave të çmuara (flori, argjenti dhe gure të çmuara). Tregti me shumicë dhe pakicë të këtyre mallrave të çmuara. Tregti dhe import në formën e bizneseve ose llogarëve. Konsulencë, vlerësim, ekspertim, dhe të dhëna të lidhura me materialet e çmuara dhe arin e përdorur, mbledhjen dhe shitjen e tyre për firmat vendase e të huaja, të specializuara, eventualisht edhe për shpërndarjen e tyre dhe transformimin në llogarë. Je veprimtarinë e shërbimeve që lidhen me ato kryesore si për shembull organizimin e eventeve, panairëve dhe ekspozitave. përgatitjen e ankandëve edhe online. Ndermjetësimin tregtar në sektorin e sipërpermdur, edhe 2 nëpërmjet pajisjeve elektronike. telematike, marrjen për sipër dhe administrimin e mandateve të agjencive dhe atyre përfaqësuese me ose pa depozitë, koordinimin dhe administrimin e rrjeteve të saj franchising dhe për llogarë të palëve të treta, me konsulentat përkatëse administruese dhe të marketingut. Shoqëria mund të marrë pjesë në përfitimet apo kuotat e shoqërive të tjera të cilat kanë objekt të ngjashëm dhe që lidhet me objektin e saj dhe se fundi mund të kryejë çdo veprim tregtar, të paluajtshe, të luajtshe dhe financiar që do të konsiderohet i nevojshëm dhe i duhur për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Investime, pjesëmarrje në fushën industriale turistike, në fushën agroturizëm, duke përfshirë të gjitha operacionet komerciale, ndërtimore, industriale së bashku me shërbimet përkatëse që konsistojnë në investimin, sipërmarrjen, realizimin, blerjen, shëndërrimin, kompensimin, importimin, eksportimin, ruajtjen, ndërtimin, restaurimin, montimin e produkteve, materialeve, shërbimeve përkatëse specifike në konceptimin, krijimin, realizimin dhe zhvillimin e aktivitetit hotelier-turistik, tregtimin e mallrave të ndryshme me shumicë dhe pakicë, veprimtari në fushën e shit-bletjes si dhe të gjithë formave të qirasë apo të shfrytëzimit të pasurive të patundshme.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) Euro i konvertuar me kursin e këmbit të Bankës së Shqipërisë në vlerën 1.160.000 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lek, kapital i ndarë në 1 (një) kuota, pra 100% (njëqind për qind).
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortaku i vetëm, i ndarë në 1 (një) kuota, pra 100 (njëqind)% të kapitalit themeltar të shoqërisë:
- **Znj. ORLANDA DI SALVATORE**, shtetase Italiane, i bija e Vincenzo, lindur më 02.11.1968 në Ortona (Ch), Itali dhe banues në Ortona, Itali, mbajtës e pasaportës nr. YA4870455, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke përfaqësuar 100 % (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Neni 6
Administratori

- 6.1 Administrimi i Shoqërisë do të realizohet nga administratori Znj. ORLANDA DI SALVATORE. Administratori i shoqërisë zgjidhet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Neni 7
Viti Financiar

- 7.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 7.2 Përgjatimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Neni 8
Të ndryshme

- 8.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe italiane, me të njëjtën vlerë secila.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQËRISË "NJLBITOPAFAV CONSULTING"
SHPK**

ORLANDA DI SALVATORE

ORLANDA DI SALVATORE
